4. Osman Nuhiu, d.v.
5. Muhamet Shabani, d.v.
6. Halit Kryeziu, d.v.
7. Nazmi Keimendi, d.v.
8. Milazim Vitia, d.v.
9. Nazif Berisha, d.v.
10. Malike Bajoku, d.v.
11. Agusn Balaj, d.v.
12. Daut Jashanica, d.v.
13. Ismail Saniti, d.v.
14. Selami Gashi, d.v.
15. Agim Morina, d.v.
16. Uke Gashi, d.v.
17. Feti Broci, d.v.
18. Baki Krasniqi, d.v.
19. Nezar Salanu, d.v.
20. Nazif Matoshi, d.v.
21. Nebih Abdullahu, d.v.
22. Isam Gashi, d.v.
23. Shemsedin Bytyqi, d.v.
24. Adem Vitia, d.v.
25. Adem Mikullovi, d.v.
26. Hilmi Muhaxheri, d.v.
27. Halim Demaj, d.v.
28. Naser Gashi, d.v.
29. Raif Ramabaja, d.v.
30. Burim Muhaxheri, d.v.
31. Fetije Shala, d.v.
32. Ilirijana Jusufi, d.v.
33. Adem Ademi, d.v.
34. Veli Haxha, d.v.
35. Azem Naziri, d.v.
36. Qamil Bajraktari, d.v.
37. Kamiz Bacaj, d.v.
38. Sabit Berisha, d.v.
39. Lucia Laqi, d.v.
40. Muharem Shabani, d.v.
41. Mehmet Ibrahimaj, d.v.

- |                               |                              |
|-------------------------------|------------------------------|
| 42. Sokol Prokshi, d.v.       | 77. Mikereme Nishiu, d.v.    |
| 43. Hysen Bashota, d.v.       | 78. Enver Pula, d.v.         |
| 44. Murtez Rrahmani, d.v.     | 79. Sanije Çitaku, d.v.      |
| 45. Hysni Salihu, d.v.        | 80. Gani Miftari, d.v.       |
| 46. Valentin Domniku, d.v.    | 81. Jahir Bekteshi, d.v.     |
| 47. Xhevat Pllana, d.v.       | 82. Maxhun Shala, d.v.       |
| 48. Jusuf Konjufca, d.v.      | 83. Gafur Kiseri, d.v.       |
| 49. Rifat Rifati, d.v.        | 84. Ilaz Ramajli, d.v.       |
| 50. Selim Krasniqi, d.v.      | 85. Sabri Hashani, d.v.      |
| 51. Tafil Salihu, d.v.        | 86. Skënder Skënderi, d.v.   |
| 52. Ramadan Kelmendi, d.v.    | 87. Qemajl Sahatçiu, d.v.    |
| 53. Remzi Maliqi, d.v.        | 88. Qazim Kelmendi, d.v.     |
| 54. Avdi Grajqevci, d.v.      | 89. Skënder Allu, d.v.       |
| 55. Isak Restelica, d.v.      | 90. Ethem Bekeri, d.v.       |
| 56. Fehmi Nallbani, d.v.      | 91. Gani Vula, d.v.          |
| 57. Ruzhdi Bakalli, d.v.      | 92. Xhemajli Bajra, d.v.     |
| 58. Bajram Arifi, d.v.        | 93. Nezir Prokshi, d.v.      |
| 59. Flamur Xhiha, d.v.        | 94. Veton Shala, d.v.        |
| 60. Gëzim Lipoveci, d.v.      | 95. Nikollë Shaban, d.v.     |
| 61. Shems Hajdini, d.v.       | 96. Halli Maxhari, d.v.      |
| 62. Feride Hyseni, d.v.       | 97. Isa Shefkju, d.v.        |
| 63. Qefsere Boshnjaku, d.v.   | 98. Zijadin Salihu, d.v.     |
| 64. Afijete Azizi, d.v.       | 99. Ali Shahini, d.v.        |
| 65. Refika Belegu, d.v.       | 100. Gëzim Haka, d.v.        |
| 66. Binaze Jashari, d.v.      | 101. Jakup Bullatovci, d.v.  |
| 67. Hanife Elshani, d.v.      | 102. Adnan Zhelta, d.v.      |
| 68. Kadrije Ismajli, d.v.     | 103. Tafil Berisha, d.v.     |
| 69. Leonora Zajmi, d.v.       | 104. Basri Bajrami, d.v.     |
| 70. Besa Basha, d.v.          | 105. Mehmet Sahatçiu, d.v.   |
| 71. Gjyljeta Mulla, d.v.      | 106. Bahri Abazi, d.v.       |
| 72. Selviqe Xhinaj, d.v.      | 107. Muhamet Ahmeti, d.v.    |
| 73. Gjëmajl Dizdari, d.v.     | 108. Xhevat Zejnullahu, d.v. |
| 74. Nijazi Hoxha, d.v.        | 109. Shaban Hashani, d.v.    |
| 75. Kadrije Dajqi Gashi, d.v. | 110. Fatos Pula, d.v.        |
| 76. Imer Gashi, d.v.          | 111. Nazmi Fejzullahu, d.v.  |

#### PERMBAJTJA

##### Kuvendi i Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës

Deklarata kushtetuese mbi Kosovën si një-si e pavarur dhe e barabartë në kuadër të Federatës (Konfederatës) të Jugosllavisë si subjekt i barabartë me njësitë e tjera në Federatë (Konfederatë)

733

Boton Organizata Gazetaro-Botuese „Gazeta zyrtare e KSAK“ — Prishtinë, rruga APJ 2, F.P. 162.  
Telefonat: drejtori 32-978 administrata dhe kontabiliteti 32-981, Drejtor dhe redaktor përgjegjës Alush Salihu, Parashënia për vitin 1990 është 200 dinarë. Xhirrollogaria 68400 — 603 — 1221 SHKSH —  
E-mail: ne@proton.rs, reklamacionet@proton.rs

SHKËMBIM: SHKËMBIM — SHKËMBIM









## PROCESVERBAL

Nga mbledhja XXVII e Kuvendit të Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, mbajtur më 14. 06. 1990, ora 12,00 në lokalet e Akademisë.

Të pranishëm akademikët: Musa A. Haxhiu, Mark Krasniqi, Gazmend Zajmi, Dervish Rozhaja, Esad Mekuli, Idriz Ajeti, Jashar Rexhepagiq, Minir Dushi, Muslim Mulliqi, si dhe anëtarët korrespondentë: Enver Gjerqeku dhe Remzi Bakalli.

Mungojnë akademikët: Bozhidar Jovanoviq, Lubisha Rakiq, Osman Imami, Sinan Hasani, Syrja Pupovci, Svetomir Arsiq, Rexhep Qosja Vladeta Vukoviq, Vukashin Filipoviq, si dhe anëtari korrespondent Dragosllav Pejçinoviq.

Në mbledhje mori pjesë edhe Mr Zija Bylykbashi, sekretar i Akademisë.

Punën e Kuvendit e përcollën edhe gazetarë të mjeteve të informimit publik.

Mbledhjen e kryesoi akademiku Musa A. Haxhiu, Kryetar i Akademisë.

Para se të fillojë nga puna mbledhja e Kuvendit, sekretari i Akademisë i lexoi telegramet të cilat i erdhën udhëheqjes së re të Akademisë me rastin e zgjedhjes së tyre në Kryesinë e ASHAK.

Kuvendi njëzërit vendosi që pika e parë e rendit të ditës të propozuar, përkatësisht miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet XXV e XXVI të Kuvendit të Akademisë të shtyhet për mbledhjen e ardhshme të Kuvendit dhe që Kuvendi të punojë në dy pjesë.

Në pjesën e parë të shqyrtohën këto pika:

Zgjedhja e Ganxhe Bojaxhiut - Nënës TEREZE anëtare nderi e ASHAK;

Shqyrtimi i projektamandamenteve në Kushtetutën e RSFJ-së.

Në pjesën e dytë të punës së Kuvendit do të shqyrtohen propozimet e seksioneve dhe të Kryesisë lidhur me realizimin e Programit të punës së Akademisë.

### Ad. 1. -

Kryetari i Akademisë e lexoi propozimin e Kryesisë së Akademisë e cila në mbledhjen e saj të datës 12.06.1990 njëzërit e ka përkrahur propozimin e Seksionit të Shkencave të Natyrës të Akademisë që Gonxhe Bojaxhiu - Nëna

Tereze të zgjidhet anëtare nderi e Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës.

Propozimi u përkrah njëzërit dhe u përshëndet me duartrokitjen e të pranishmëve.

Pas kësaj Kryetari i Akademisë konstatoi se Gonxhe Bojaxhiu Nëna Tereze, pasi që i përmbush të gjitha kushtet e parapara me Ligj dhe Statut u zgjodh anëtare nderi e Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës.

Teksti i propozimit për zgjedhjen e Gonxhe Bojaxhiu - Nënës Tereze anëtare nderi e ASHAK është pjesë përbërëse e këtij procesverbal.

#### Ad . 2 . -

Në kuadrin e kësaj pike të rendit të ditës u përkrah qëndrimi i Kryesisë së Akademisë që krahas shqyrtimit të projektamendamenteve në Kushtetutën e RSFJ-së të debatohet edhe për pjesën e tekstit të propozimit të Kryesisë së RSS për nxjerrjen e Kushtetutës së re të RS të Serbisë, i cili ka të bëjë me qenien dhe pozitën kushtetuese të krahinave socialiste autonome, përkatësisht me qenien dhe pozitën kushtetuese të KSA të Kosovës. Duke u bazuar në konkluzën e Kryesisë së Akademisë të datës 25.05.1990, fjalën me vërejtjet hyrëse për projektamendamentet në Kushtetutën e RSFJ-së si dhe për pjesën e tekstit të propozimit të Kryesisë së RSS për nxjerrjen e Kushtetutës së re të RS të Serbisë e paraqiti akademiku Gazmend Zajmi. Pas kësaj u hap diskutimi si për fjalën e hyrjes po ashtu edhe për propozimin e tekstit të Deklaratës së Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës mbi çështjet kushtetuese, të cilin anëtarët e Kuvendit e kanë marrë më herët. Diskutuan Mark Krasniqi, Enver Gjerçeku, Dervish Rozhaja dhe Minir Dushi, të cilët e përkrahën fjalën e hyrjes dhe tekstin e Deklaratës së ASHAK mbi ndryshimet kushtetuese. Edhe anëtarët e tjerë të pranishëm të Kuvendit të Akademisë i përkrahën dokumentet në fjalë, përkatësisht fjalën e hyrjes kushtuar çështjeve kushtetuese me rastin e debatimit për projektamendamentet në Kushtetutën e RSFJ-së dhe për orientimet rreth krahinave socialiste autonome në propozimin e Kryesisë së RS të Serbisë për nxjerrjen e Kushtetutës së re të RS të Serbisë dhe Deklaratën e ASHAK mbi çështjet kushtetuese. Teksti i Fjalës së hyrjes dhe i Deklaratës janë pjesë përbërëse të këtij procesverbali.

Me këtë përfundoi pjesa e parë e punës së Kuvendit në ora 14:00.

Pjesa e dytë e punës së Kuvendit përkatësisht shqyrtimi i pikës së tretë të rendit të ditës filloi në orën 14:30.

### Ad.3.-

Shqyrtimi i propozimeve të seksioneve dhe të Kryesisë së Akademisë lidhur me realizimin e Programit të punës së Akademisë.

Kuvendi e shqyrtoi dorëheqjen me shkrim e të pa revokueshme të akademikut Vlladeta Vukoviq në funksionin e sekretarit të Seksionit të Gjuhësisë, Letërsisë dhe të Arteve, për shkaqe shëndetësore. Meqenëse kjo dorëheqje paraprakisht është shqyrtuar edhe në Kryesinë e Akademisë dhe se Kryesia lidhur me këtë ka marrë qëndrim që t'i propozojë Kuvendit ta miratojë dorëheqjen në fjalë, Kuvendi i Akademisë njëzërit e miratoi këtë dorëheqje. Njëkohësisht Kuvendi e miratoi propozimin e Seksionit që Enver Gjerqeku të zgjidhet sekretar i Seksionit të Gjuhësisë, Letërsisë dhe të Arteve.

Kuvendi u informua për vizitat që i bëri udhëheqja e Akademisë disa institucioneve shkencore të Kosovës, siç mund të shihet edhe nga informata (e shkurtër) e përgatitur me shkrim për këtë mbledhje. Kryetari i Akademisë, në fjalën e tij, tha se kjo iniciativë u mirprit nga të gjitha institucionet me të cilat patëm kontakte dhe se do të vazhdohej përpjekjet për vënien e kontakteve edhe me institucionet e tjera shkencore të Krahinës.

Kuvendi miratoi informatën mbi vizitat që i bëri udhëheqja e Akademisë disa institucioneve shkencore të Kosovës duke e çmuar këtë hap si të qëlluar dhe i cili do të begatojë punën kërkimore-shkencore si të Akademisë ashtu edhe të institucioneve shkencore të Kosovës.

Kuvendi i përkrahu propozimin që Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës bashkë me Fakultetin e Mjekësisë të mbajnë Simpoziumin shkencor me temën "Ndriçimi i shkaqeve të simptomokompleksit psikosomatik me natyrë joinfektive tek nxënësit në trevën e Kosovës, në tremujorin mars-maj 1990", në fund të tetorit apo në fillim të nëntorit të këtij viti.

Kuvendi u pajtua që të gjitha seksionet dhe të gjithë anëtarët e Akademisë të punojnë në drejtim të përgatitjes së planit pesëvjeçar të punës së Akademisë.

Kuvendi e përkrahu planin dhe programin e punës së Seksionit të Shkencave të Natyrës bashkë me shkoqitjen përkatëse financiare me sugjerimin që edhe

seksionet e tjera të Akademisë ta përgatisin konstruktin financiar përkatës për realizimin e planeve dhe programeve të tyre të punës.

Në fund të mbledhjes Kryetari i Akademisë u ofroi anëtarëve të Akademisë për lexim zyrën e tij, për çdo ditë prej orës 7-13, me ç'rast ata do ta kenë në dispozicion shërbimin profesional të Akademisë.

Mbledhja u mbyll në orën 15:30.



*Nga mbledhja e Kuvendit të ASHAK-ut, më 14 qershor 1990*

Kopje e punës  
në Komisionin Kushtetues

Akademik Gazmend Zajmi

Fjala hyrëse në Kuvendin e Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës të datës 14.VI.1990 kushtuar çështjeve kushtetuese me rastin e debatimit për projekamandamentet në Kushtetutën e RSFJ dhe për orientimet rreth krahinave socialiste autonome në propozimin e Kryesisë së RS të Serbisë për nxjerrjen e Kushtetutës së re të RS të Serbisë.

Kolegë të nderuar,

Sot jemi tubuar në Kuvendin e Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, që me ftesë të drejtëpërdrejtë të Komisionit Kushtetues të Kuvendit të RSF të Jugosllavisë të debatohet për projekamandamentet në Kushtetutën e RSF të Jugosllavisë të cilat i përcaktoi Dhoma Federative e këtij Kuvendi, e që më parë i pat inicuar Këshilli Ekzekutiv Federativ, si dhe që me vetëiniciativën e Kryesisë së Akademisë tonë të debatohet rreth pjesës së tekstit të propozimit të Kryesisë së RS të Serbisë për nxjerrjen e Kushtetutës së re të RS të Serbisë në të cilën përmbahen orientimet e këtij organi për qenjen dhe pozitën kushtetuese të krahinave socialiste autonome.

Natyrisht jo më pak do të deshironim që qyteti para vetes të kishim tekstin e orientimeve burimore të Kuvendit të Kosovës për pozitë të re kushtetuese të Kosovës, pavarësisht nga orientimet e të tjerëve, e aq më parë pavarësisht nga orientimet degraduese ndaj kësaj pozite.

Mendoj se debatimi ynë sot i njëkohshëm i të dy këtyre dokumenteve (projektamandamenteve në Kushtetutën e Jugosllavisë dhe i pjesës së tekstit të propozuar të Kryesisë së RS të Serbisë mbi nxjerrjen e Kushtetutës së re të RS të Serbisë, që ka të bëjë me krahinat socialiste autonome) simbolizon dhe shpreh një të vërtetë të madhe, një të vërtetë të pamohueshme se nuk mund të ketë jo vetëm pozitë afirmative kushtetuese të Kosovës në Federatë, por në esencë kurrëfarë pozite përveç pozitës ekspozitive, duke u grryer dhe thermitur vazhdimisht individualiteti i Kosovës në kuadër të RS të Serbisë.



Sëkondejmi mendoj se debatimi ynë rreth këtyre dy dokumenteve është një voli e natyrshme që të rrahen sot çështje esenciale të rendit kushtetues në Jugosllavi me interesim të kryefillshëm për pozitën kushtetuese të Kosovës në këtë rend kushtetues dhe pozitën e popullit shqiptar në Jugosllavi si subjekt politik kushtetues në kuadër të trajtave institucionale të barazisë kombëtare në Jugosllavi, përkatësisht në kuadër të rendit federativ-konfederativ.

Përballë, dhe ballafaquar me këto çështje kapitale, besoj se ky Kuvend sot nuk ka pse të merret me gjëra të dorës së dytë dhe të tretë, me çështje të imta juridiko-teknike, me çështje të sistemit të hindit normativ. Sikurse thënja në latinisht "De minimis non curac praetor" (Me vogëlsira nuk merret pretori) ishte dashur të vlejë edhe për Akademinë në këtë rast të alokuar në koordinata kohore të erërave, vërtomave dhe vorbullave politike në Jugosllavi ku deshirohen të qepën fatet e popujve sipas kuteve unitariste dhe hegjemoniste, ku deshirohet të zihet hapi dhe pozicioni i parë për të gjitha opcionet me Jugosllavinë. Në këtë dhe qëndron kuptimi i propozimit të Kryesisë së kësaj Akademie të letrës-deklaratës për çështje kushtetuese e cila pritet të aprovohet në këtë Kuvend.

Është për t'u besuar se ne sot këtë bisedë kushtetuese e bëjmë me përgjegjësi të shtuar duke pasur parasysh edhe faktin se sot, e të thuash që dhjetë vite , mbi Kosovën u derdhën dhe po derdhën jo vetëm shumë procka por edhe lumenjë të kundërkushtetutshmerisë, por që shikuar historikisht "infuturo" lymi i antikushtetutshmerisë do të ngelë në vetë burimet e këtyre lumenjëve, por edhe me shpresë se këtë lym do ta shpërtresin të reshurat demokratike në Europë.

Në këtë fjalë hyrëse duke mos i zbrërthyer detajisht trajtat e represionit flagrant dhe ekzobitant shtetror në Kosovë si antitezë e bërthamës së kushtetutshmerisë, trajta këto që shtrihen nga shqiptimi i disa milenjumeve vite burgimesh, duke përfshirë këtu edhe izolimet famëkeqe e deri te goditja me armë zjarri e më se një qerek milioni demonstrantësh shqiptarë që në esencë kërkuan demokraci, barazi, dinitim reciprok dhe avancim të pozitës kushtetuese të Kosovës në Jugosllavi, e ku shumë prej tyre edhe ju shua jeta; duke mos zbrërthyer të ashtuquajturat valë dhe rrrathë të dife-

rencimit antikushtetues të qytetarëve në sferën e punës në bazë të monopolit njëpartiak;

duke mos zbrërthyer simultanizmin e paparë kund në botë dhe alterimin e dy gjendjeve të jashtëzakonshme në Kosovë: nominalo-faktike dhe faktike me prezencë të njëkohëshme të dy eshalloneve milicore, atë të Jugosllavisë dhe atë të Serbisë, e që këto eshallone mos për hirë të demokracisë, për hirë të rezonit shtetëror, do të duhej ta lëshonin Kosovën dhe të lihet organeve legale-krahinore kujdesi për rendin publik në Kosovë;

duke mos i detajuar me shembuj notorë mospërfilljet zyrtare për atakim emrast dhe monumentesh të historisë dhe kulturës shqiptare, proporcionet diskriminante në punësim dhe diskriminim në arsim kundruall strukturës reale kombëtare të popullsisë në Kosovë, urdhëresat për segregim në arsim, cenimet e rënda të autonomisë së enteve shëndetësore nga ana e milicisë, bashkë me indolencën dhe fytyrjen e rëndë të ndjenjave njerëzore dhe kombëtare të shqiptarëve nga personat më të lartë të kreut të shtetit, për gjoja simulim të më së pesëmijë fëmijësh të morbidizuar, nga çfarëdo agensi apo kombinim agensash që mund të jetë fjala.

duke mos i liruar në këtë rast hollësisht synimet dhe veprimet problematike të ashtuquajturit "drejtëpeshim etnik" me humbje të pamangëshme të drejtëpeshimit politik për shkak të barrës së rëndë me shifra dhe afate të qëllimshme, me etnomani dhe etnofobi që prodhon dhe alokim egoist dhe etnoman të investimeve ekonomike në trungun ndërretnik të hapësirës kosovare, - krahas gjithë kësaj, dhe përbri kësaj, mjafton të përmendim urdhëresën jokushtetuese dhe kundërkushtetuese të Këshillit Ekzekutiv të Serbisë, kur ky organ, përveç që abstrakton organet e pushtetit të Krahinës, si organ ekzekutiv urdhëron, me kërcnim dhe veprim të milicisë, që mos të zbatohën nga ana e organeve punëdrejtuese të organizatave dhe institucioneve, vendimet e këshillave të punëtorëve si organe më të vjetra me kushtetutë dhe ligj, madje mos të zbatohen dhe vendimet konkrete të gjykatave në Kosovë, në vend të raportit të anasjelltë të paraparë me Kushtetutë në mes të gjykatave dhe organeve ekzekutive. Ky shembull padyshim ka për të hyrë në analet e veprimeve më të shënueshme kundërkushtetuese në veprimin e një

organi ekzekutiv.

Ja, kjo është sot gjendja e idhët e kushtetutëshmërisë në Kosovë, thënë më saktë, gjendja e idhët e jokushtetutëshmërisë ndaj Kosovës, e ne nga ana e organeve federale, në emër të kushtetutëshmërisë dhe demokracisë jemi ftuar që të debatojmë për amandamentet në Kushtetutën e RSF të Jugosllavisë.

Nuk ka dyshim se çfarëdo gjendje dhe qëndrim yni apatik ndaj kësaj ironie të jetës dhe padrejtësie të kohës, do të ishte përgjigja jonë më e dobët. Nuk kemi të drejtë ta mbështjellim veten/<sup>me</sup>gëzof të ngrohtë akademik në këto shkuja të kohës. Nuk kemi të drejtë të bëmë në përqafim miklues të ndonjë shkence shoqërore, të imagjinuar virgjine jashtë pulsimeve të kohës dhe të popullit në rrafshin e restrukturizimit të rendit kushtetues.

Për hirë të rangut të dokumenteve, dhe koherencës kushtetuese-juridike, të shohim më parë në vija të shkurtëra se për çka bëhet fjalë në projektamandamentet e Kushtetutës së RSFJ, cilat janë pikat kyçe dhe tangenciale të këtyre amandamenteve, ndonëse vektorët kryesorë të përbysjes së çfarëdo autonomiteti të Kosovës gjenden në dokumentin e Kryesisë të RS të Serbisë në ndeshë me individualitetin dhe qenien shoqërore të Kosovës, në ndeshë me vullnetin dhe kërkesat e gjëra demokratike dhe legjitime të shumicës së popullatës së Kosovës, në ndeshë me zërin e arsyes dhe të drejtësisë, të rrjedhave shoqërore dhe kombëtare, në ndeshë jo vetëm me logjikën por edhe me objektivitetin e ecurive historike dhe demokratike.

Kur është fjala për projektamandamentet në Kushtetutën e RSF të Jugosllavisë, që në fillim duhet të kihet parasysh se kemi të bëjmë me propozim ndryshimet pjesore të Kushtetutës së RSFJ, që si të tilla i paraprijnë përgatitjeve për nxjerrjen e Kushtetutës së re të Jugosllavisë, por që megjithëkëtë kapin një dimension të gjërë të ndryshimeve kushtetuese me rëndësi të padyshimtë për rrjedhën e reformave ekonomike dhe politike në momentin e pikërishtëm.

Krahas vërejtjeve dhe sugjerimeve me rëndësi që mund t'i bëhen projektamandamenteve, e posaçërisht vërejtjet tejet serioze në nivel të mospranimit të alternativës së alinesë së parë të amandamentit 84 e cila prek në proporcionet e përfaqësimit

të republikave dhe krahinave në Dhomën Federative të Jugosllavisë në dëm të krahinave autonome dhe amandamentit 70 i cili prek në procedurën kushtetuese të tanishme të koncensusit të republikave dhe të krahinave në fazën e parë të iniciativës për ndryshime të Kushtetutës, mund të thuhet se në mënyrë gjenerale duhet përkrahur orientimet themelore të projektamandamenteve që kanë të bëjnë me demokratizimin e jetës politike dhe ekonomike e që janë:

1. pluralizmi i trajtave të pronës dhe tregu i lirë në funksion të dinamizmit dhe të zhvillimit të forcave materiale të shoqërisë dhe prosperitetit social dhe të gjithëmbarshtëm në shoqëri;
2. pluralizmi politik duke përfshirë dhe dimensionin e shumëpartiaksisë;
3. zgjedhjet e lira, të drejtëpërdrejta dhe të fshehta në konstituimin e organeve të pushtetit;
4. zgjerimi i sferës së lirive dhe të drejtave të njeriut dhe qytetarit si dhe garancia e shtuar kushtetuese e tyre.

Përkrahja jonë e këtyre orientimeve është thellësisht e natyrës principiell dhe e frymëzimit tonë demokratik. por është edhe në përkim organik me faktin se asnjë regjion në Jugosllavi sa më Kosova nuk është më i etshëm për liri dhe të drejtat e njeriut për demokratizim të jetës politike dhe për zhvillim ekonomik.

Dihet mirëfilli se nisma, por deridiku dhe përmbajtja e këtyre projektamandamenteve ka radius të kufizuar në çështjet e marrëdhënieve në Federatë e që ato lihen për shqyrtime të thelluara të mëvonshme me rastin e përgatitjes së Kushtetutës së re të Jugosllavisë e që të përmendim rrëshqitas se Kuvendi i Kosovës bëri mirë, dhe atë që u desht ta bëjë duke mos e dhënë pëlqimin me iniciativën e Kryesisë së RSFJ, përderisa nuk ndërrohen pikënisjet reduktuese të kësaj initiative në lidhje me pozitën kushtetuese të Krahinës Socialiste në Federatë, për t'u zavendësuar me pikënisje afirmative.

Mirëpo nëse që në këto amandamente të Kushtetutës së RSFJ preket në strukturën dhe proporcionet numerike të participimit të republikave dhe krahinave në Federatë, propozimi ynë nuk do të mund të ishte tjetër pos propozim për numër të njëjtë të përfaqësuesve të krahinave socialiste autonome me republikat në Federatë,

e kjo gjithësesi për rastin e Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës. Në këtë propozim nuk është fjala për ndonjë afekcion aprioristik ndaj simetrisë, por për çasje esenciale ndaj barazisë kombëtare, e në këtë drejtim, për rieke të zgjerimit të kanaleve institucionale ku do të vinte në shprehje të drejtë dhe adekuate malliteti demografik dhe hapësinor i popullit shqiptar në Jugosllavi si një ndër popujt më numerikë në të. Ç'kuptim principialiteti në fushën e barazisë kombëtare ka, bie fjala, fakte se në seancat deliberative dhe të vendosjes në Gjykatën Kushtetuese të Jugosllavisë marrin pjesë p.sh. dy gjykatës kroatë, dy gjykatës malazias e një ose asnjë gjykatës kushtetues shqiptar. Sigurisht se interesi për mbrojtje dhe promovim të kushtetutshmërisë në vend është aspak më i paktë në qenien kombëtare dhe politike dhe nevojën reale të shqiptarëve në Jugosllavi.

Në këtë rast, thënë kjo dhe si hallkë lidhëse për vështirimi pasues të orientimeve të Kryesisë së RS të Serbisë lidhur me krahinat socialiste autonome, do të duhej posaçërisht të përkujtohen dy pikënisje kushtetuese: një, edhe sipas parimeve themelore të Kushtetutës edhe sipas dispozitave normative të saja ( neni 2 i Kushtetutës së Jugosllavisë mbi atë se kush e përbën Jugosllavinë) krahinat socialiste autonome janë pjesë, pra të nënvizohet pjesë konstitutive të Federatës dhe jo vetëm element konstitutiv i Federatës, sintagmë kjo e fundit që në mënyrë joadekuate është futur në zhargonin politik. Me këtë sintagmë sot po lecitohet edhe nga ana e disa funksionarëve të lartë të cilët dikur e trumbetonin si konstantë të pacenueshme, por dhe si alibi për arbitraritet dhe kalkulatizëm në përkrahjen e amandamenteve të marsit të Kushtetutës së RŞ të Serbisë.

Dy, edhe sipas parimeve themelore të Kushtetutës së Jugosllavisë dhe dispozitave normative të saj dhe kushtetutave të krahinave socialiste autonome, ato nuk janë në kuptim të përgjithshëm autonomi territoriale, por janë autonomi politiko-territoriale, dhe ajo që është edhe më e shënueshme, nuk janë vetëm autonomi politiko-territoriale, por janë edhe njësi federale.

Kushtetuta e Jugosllavisë duhet të lexohet dhe shpjegohet ashtu siç është "De constitutione lata", dhe jo si dëshirohet "De constitutione ferenda".

Të shohim tani konkretisht se me çfarë orientimesh në lidhje me qenien dhe pozitën kushtetuese të krahinave socialiste autonome, pra në lidhje me qenien dhe pozitën kushtetuese të Kosovës ndeshemi në propozimin e Kryesisë të RS të Serbisë për nxjerrjen e Kushtetutës së re të RS të Serbisë.

Këto orientime janë:

1. defederalizimi dhe desubjektivizimi total politik i Krahinës, duke u reduktuar qenia dhe pozita e saj kushtetuese në trajtë të thjeshtë, të përgjithësuar dhe të kufizuar "të autonomisë territoriale" në, siç thuhet, "kufijtë rreth veprimit" të përcaktuar me Kushtetutën e Serbisë;

2. dekonstitucionalizimi i Kushtetutës së Kosovës dhe shndërrimi i saj në Statut, madje edhe në Statut moshëvogël të lidhur me pëlqimin dhe verifikimin e organeve të Republikës së Serbisë, çka nuk parashihte as Kushtetuta e vitit 1963;

3. derogimi normativ konkludent i principit kushtetues të barazisë së gjuhëve me pasoja juridike evidente degraduese statutores të gjuhës shqipe në Kosovë nëpërmjet të konstituimit të gjuhës shtetërore serbe dhe të shkrimit qirilik në Republikë në tërësi, pra edhe në Kosovë, me parashikim të përdorjes zyrtare "edhe të gjuhëve të kombësive" në territoret ku ato jetojnë "në pajtim me Ligjin", pra në varësi nga ligji dhe kuti i tij pa proklamim paraprak kushtetues të barazisë së gjuhëve;

4. Substituimi i emrit "Kosovë" me emërtim "Kosovë e Metohi" në papërputhje me vlerat dhe standardet gjuhësore toponomastike të shumicës së popullsisë që jeton në Kosovë, Në kundërshtim me vullnetin e popullit shqiptar në Kosovë, dhe në kundërshti me emërtimin zyrtar të Krahinës në Kushtetutën e Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës dhe në Kushtetutën e Republikës Socialiste të Jugosllavisë;

5. konstituim retrograd dhe i pakuptueshëm për botën e sotme, ku janë në shuarje "izmat" dhe në kontinentin më të ngrohtë tropikal i dallimeve në mes të qytetarëve dhe kolektiviteve nacionale në Kosovë ku qytetarët serbë dhe malazias nga pakica-demografike në Kosovë, konsiderohen si qytetarë të pajisur "me sovranitet të kombeve", ndërsa, "argumentum a contrario" shqiptarët si qytetarë të shumicës së popullsisë të Kosovës, na dalin si qytetarë të rendit të dytë, qytetarë josovranë, meqë sipas këtij koncepti nuk janë të pajisur me "sovranitet të kombeve".

Mendoj se në këtë çast të përfundimit të prezentimit të orientimeve të Kryesisë së RS të Serbisë në lidhje me qenien dhe pozitën kushtetuese të krahinave socialiste autonome, përkatësisht në lidhje me qenien dhe pozitën kushtetuese të Kosovës, mbaron roli i fjalës hyrëse. Gjërat janë që të qarta në vrazhdësinë e unitarizimit dhe hegjemonizimit ndaj Kosovës, në vrazhdësinë e opresivitetit ndaj popullit shqiptar në Jugosllavi dhe shprehjes politiko-kushtetuese të tij në rendin kushtetues, në të konceptuarit retrograd nacional-posesiv të Kosovës si tokë serbe e jo si tokë

e të gjithë qytetarëve dhe të gjitha nacionaliteteve të Kosovës, me të harruar se krahas strukturës reale nacionale dhe demografike të Kosovës, asnjë popull i Kosovës nuk është pa trugun dhe rrënjët e tija historike në të, sa që në këtë qartësi, çdo zbërthim më i gjërë politik, historik, nacional, kushtetues, juridik i orientimeve të Kryesisë së RS të Serbisë, kishte për të dalur i sforcuar për natyrën e fjalës hyrëse dhe kështu do të spostohej në pjesën e diskutimit në këtë Kuvend.

Mendoj se gjëja më e dështuar në këtë debatim tonin për çështje kushtetuese me rastin e këtyre dy projekt-dokumenteve kushtetuese që i kemi para vëtes kishte për të qenë vuarja e jonë kundruall synimeve të përshkruara më sipër në pozitë defanzive të mbrojtjes së pozitës kushtetuese të Kosovës e cila thellësisht u cungua me amandamentet e marsit të vitit 1989 në Kushtetutën e RS të Serbisë jo vetëm kundër vullnetit të qartë, dhe herë herë vullkanik, të shumicës së popullatës në Kosovë, por dhe të imponuara me presion dhe procedurë jokushtetuese në procesin e deklarimit të Kuvendit të Kosovës për amandamente në mars të vitit të kaluar, muaj ky me emër të një nga perëndive pagane. Le t'i shtohet kësaj dhe degradimi i mëtejme i autonomisë nepërmjet të imponimit politik të ashtuquajturëve "ligje unike me ujdi" në sferën e arsimit dhe sferat e tjera të jetës.

Sëkunderjmi qasja jonë ndaj çështjeve kushtetuese në përgjithësi dhe çështjes së pozitës kushtetuese të Kosovës duhet të jetë qasje kreative dhe me program pozitiv në dhënje të respektimit të dinjitetit njerëzor dhe nacional të njeriut, qytetarit dhe kolektiviteteve njerëzore dhe nacionale, në shenjë të ngritjes së respektit, miqësisë, barazisë dhe ngrohtësisë së ndërsjellë në mes të njerëzve dhe nacionaliteteve në Kosovë, të cilët me shekuj e shekuj jetuan së bashku në këto hapësira pa pasur nevojë për gara shterpe politike se cili prej tyre është më i lashtë në këto hapësira, në shenjë të ngritjes dhe thurrjes së marrëdhënieve të reja dhe të miqësisë në mes të popullit serb dhe popullit shqiptar në Jugosllavi në dobi të mirëqenies së tyre demokratike, në shenjë të mirëqenies dhe stabilitetit të Jugosllavisë mbi bazën e barazisë kombëtare, të respektit dhe të miqësisë reciproke në mes të njerëzve dhe nacionaliteteve të saja.

Kjo dhe që pikënisja themelore metodologjike e Kryesisë së kësaj Akademie e cila përcaktoi propozimin e Letrës-deklaratës së Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës mbi çështjet kushtetuese, për të cilën lutë që ky Kuvend t'a aprovojë.



*AKADEMIA E SHKENCAVE DHE E ARTEVE E KOSOVËS*

*Rruga "Agim Ramadani" p.n.*

*10 000, Prishtinë*

*Republika e Kosovës*

*Tel.: +381 38 249 303*

*ashak@ashak.org*